



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 340 Prot.

Tiranë, më 13.032019


VENDIM Nr. 56, datë 06.03.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje". Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2 të datës 06.03.2019, pasi shqyrtoi kërkesën e ALUIZNI-it Lezhë për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "*Banesë 3 kate*" të *Z. Fatmir Preng Gjinaj, Lagjja Varosh, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Lezhës,*

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e ALUIZNI-it Lezhë për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "*Banesë 3 kate*" të *Z. Fatmir Preng Gjinaj, Lagjja Varosh, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Lezhës.*
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**